<p>përgjegjësitë civile-juridike apo konkurrencën jo lojale në treg.</p> <p>Neni 22 Marrëdhënja ndaj të drejtës së autorit</p> <p>Dizajni i mbrojtur sipas këtij ligji, mund të mbrohet edhe me dispozitat e ligjit për të drejtën e autorit nga momenti i krijimit apo fiksimit të tij në çfarëdo forme, nëse i plotëson kushtet e dispozitave të ligjit që rregullon të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.</p> <p>KREU VI</p> <p>DIZAJNI INDUSTRIAL SI OBJEKT I PRONËSISË</p> <p>Neni 23 Transferimi</p> <p>1. Dizajni industrial mund të transferohet tek personat e tjerë.</p> <p>2. Transferimi regjistrohet në regjistër dhe publikohet në buletin e Zyrës me kërkesë të ndonjëres nga palët në bazë të marrëveshjes paraprake në mes tyre.</p>	<p>responsibilities or non-loyal competition in the market.</p> <p>Article 22 Relationship to copyright</p> <p>The protected design pursuant by this law may also be protected by provisions of the copyright law as from the date in which the design was created or placed in every form, if fulfills provisions of this law that defines the copyright and similar rights.</p> <p>CHAPTER VI</p> <p>INDUSTRIAL DESIGN AS THE OBJECT OF PROPERTY</p> <p>Article 23 Transfer</p> <p>1. An industrial design can be transferred to another person.</p> <p>2. The transfer shall, at the request of one of the parties according to their prior agreement, be registered in the register and published in the Office bulletin.</p>	<p>pravne odgovornosti ili ne lojalnu konkurenciju na trzistu.</p> <p>Član 22 Odnos prema autorskom pravu</p> <p>Dizajn koji je zasticen sa industrijskim dizajnom moze da bude pogodan i za zastitu sa odredbama zakona za autorska prava od trenutka stvaranja ili njegovog fiksiranja u bilo kojem obliku, ako ispunjava uslove odredbi zakona koji regulise autorsko pravo i približna prava.</p> <p>GLAVA VI</p> <p>INDUSTRIJSKI DIZAJN KAO OBJEKAT SVOJINE</p> <p>Član 23 Prenos</p> <p>1. Industrijski dizajn može da se prenosi kod ostalih lica.</p> <p>2. Prenos registruje se u registar i objavljuje se u biltenu Kancelarija na zahtev neke od stranaka, pod preliminarni sporazum izmedju njih.</p>
--	---	---



<p>3. Transferimi ka efekt ndaj personave të tretë pas regjistrimit në regjistër. Para regjistrimit, transferimi ka efekt ndaj personave të tretë të cilët kanë qenë në dijeni për aktin e tillë.</p>	<p>3. The transfer shall only have effect to third parties after the entry in the register. Before registration, the transfer has effect on the third parties which have been aware for such act.</p>	<p>3. Prenos ima uticaja kod trećih stranaka posle registracije u registar. Pre nego što se on registruje prenos ima uticaja prema trećim strankama koja su bila upoznata za takav čin.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 24 Licenca</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 License</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Licenca</p>
<p>1. Pronari i dizajnit industrial mund të lëshoj licencë ekskluzive apo joekskluzive për shfrytëzimin e së drejtës së dizajnit në tërësi apo pjesërisht, e cila mund të vlejë për tërë territorin e Republikës së Kosovës apo për një pjesë të tij.</p>	<p>1. The holder of industrial design may issue exclusive and non-exclusive license for using of the right of the design fully or partially, which may be valid for the whole territory of the Republic of Kosovo or a part of it.</p>	<p>1. Vlasnik industrijskog dizajna može izdati isključivo ili ne-ekskluzivnu licencu za korišćenje prava dizaja u celini ili u delovima, koja se mogu primeniti na celu teritoriju Republike Kosova, ili deo nje.</p>
<p>2. E drejta për shfrytëzimin e dizajnit industrial fitohet në bazë të kontratës së licencës dhe ka efekt ndaj personave të tretë pas regjistrimit të licencës në Regjistër.</p>	<p>2. The right for usage of the industrial design is acquired based on the licesing contract and has effect on third parties after the registration of the license in the Register.</p>	<p>2. Pravo za koriscenje industrijskog dizajna stiče se na osnovu ugovora za licenciranje dok ovo pravo ima uticaj na treće lice posle registracije licence u Registar.</p>
<p>3. Kontrata për licencën duhet të jetë në formë të shkruar dhe e nënshkruar nga ana e palëve kontraktuese.</p>	<p>3. The licesing contract shall be in written form and be signed by the contracting parties.</p>	<p>3. Ugovor za licencu da bude u pisanom obliku i da bude potpisan od strane ugovorni stranaka.</p>
<p>4. Pronari i dizajnit mund t'i realizojë të drejtat nga dizajni ndaj fituesit të licencës i cili shkelë ndonjë dispozitë të kontratës për licencën, e veçanërisht në lidhje me kohëzgjatjen e licencës dhe kufijtë e përdorimit të dizajnit.</p>	<p>4. The holder of the design may implement the rights of the design against the licensed person who infringes some provision of the contract for licensing, and especially regarding to the validity period of the license and the usage limits of the design.</p>	<p>4. Vlasnik dizajna može da ostvari prava od industrijskog dizajna naspram dobitnika licence koji je prekrasio neku odredbu od ugovora za licenciranje posebno u vezi sa dužinom vremena licence i ogranicenja upotrebe industrijskog dizajna.</p>



<p>5. Fituesi i licencës mund të inicioj kontest gjyqësor në pikëpamje të shkeljes së të drejtave që rrjedhin nga dizajni industrial vetëm nëse pronari i dizajnit industrial pajtohet me këtë.</p> <p>6. Fituesi i licencës mund të lëshoj nën licencë vetëm nëse kjo përcaktohet në kontratë.</p> <p>7. Regjistrimi i licencës bëhet me kërkesën e pronarit të dizajnit ose të fituesit të licencës, me kusht që Zyrës t'i parashtrahet kopja e kontratës për licencën.</p> <p>8. Regjistrimi i licencës publikohet në buletin e Zyrës.</p> <p>9. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e licencës përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 E drejta e pengut në dizajnin industrial</p> <p>1. Dizajni industrial mund të jetë objekt i pengut.</p> <p>2. Me kërkesën e njëjës nga palët, e drejta nga paragrafi 1 i këtij neni regjistrohet në Regjistër.</p>	<p>5. The licensed person may initiate court proceeding regarding to the infringement of the rights derived from industrial design, only if the holder of the industrial design does not agree with this.</p> <p>6. The licensed person may issue sub-license only if it is defined by the contract.</p> <p>7. The license is registered after the request for that is done by the owner of the design or of the person who received the industrial design license is delivered to the Office.</p> <p>8. The registration of the license shall be published in the Office bulletin.</p> <p>9. The form and request content for the registration of the license shall be defined by sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 The right of pledge on industrial design</p> <p>1. An industrial design may be subject of pledge.</p> <p>2. On request of one of the parties, the rights mentioned in paragraph 1 of this article shall be registered in the register.</p>	<p>5. Dobitnik licence može da pokrene sudski spor u pogledu kršenja prava koja proizlaze iz industrijskog dizajna samo ako nosilac industrijskog dizajna se ovim se slaže.</p> <p>6. Dobitnik licence može da izda pod licence (re-licence) jedino ako se ovo odredjuje u ugovoru.</p> <p>7. Registracija licence se vrši na zahtev vlasnika dizajna ili dobitnika licence pod uslovom da Kancelariji da na uvid kopija ugovora za licencu.</p> <p>8. Registracija licence objavljuje se u biltenu Kancelarije.</p> <p>9. Zahtev za registraciju licence odredjuje se sa podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Pravo na zaplenu u industrijskog dizajna</p> <p>1. Industrijski dizajn može da bude predmet zaplene.</p> <p>2. Na zahtev jedne od stranaka, pravo iz stava 1 ovog člana se registruje u registar.</p>
---	--	--



<p>3. Regjistrimi i pengut publikohet në buletin e Zyrës.</p> <p>4. Pengu krijon pasoja juridike ndaj personave të tjerë pas regjistrimit në regjistër.</p> <p>5. Forma dhe përmbajtja kërkesës për regjistrimin e pengut përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Procedura e përmbartimit</p> <p>1. Dizajni industrial mund të jetë objekt i përmbartimit.</p> <p>2. Me kërkesën e njëjës nga palët, e drejta nga paragrafi 1 të këtij neni regjistrohet në Regjistër dhe publikohet.</p> <p>3. Procedura e përmbartimit krijon pasoja juridike ndaj personave të tretë pas regjistrimit në regjistër.</p> <p>4. Forma dhe përmbajtja kërkesës për regjistrimin e përmbartimit përcaktohet me akt nënligjor.</p>	<p>3. The registration of pledge is published in the Office bulletin.</p> <p>4. The pledge creates legal consequences towards third parties after the registration in the register.</p> <p>5. The form and the content of the request for the registration of the pledge shall be defined by sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 The execution procedure</p> <p>1. An industrial design may be subject of execution.</p> <p>2. On request of one of the parties, the rights mentioned in paragraph 1 of this article shall be registered in the register and published.</p> <p>3. The execution procedure creates legal consequences towards third parties after the registration in the register.</p> <p>4. The form and the content of the request for the registration of the execution procedure shall be defined by sub-legal act.</p>	<p>3. Registracija zaplene objavljuje se u biltenu Kancelarije.</p> <p>4. Zaplena stvara pravne posledice nad ostalim licima posle registracije u registar.</p> <p>5. Zahtev za registraciju plena odredjuje se sa podzakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Postupak izvršenja</p> <p>1. Industrijski dizajna može da bude predmet postupka za izvršenje.</p> <p>2. Na zahtev jedne od stranaka , pravo iz stava 1 ovog člana registruje se u Registar i oglasava.</p> <p>3. Postupak za izvršenje stvara pravne posledice nas trećim licima polse registarcije u registar.</p> <p>4. Zahtev za registraciju izvršenja odredjuje se podzakonskim aktima.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 27 Falimentimi</p> <p>Nëse dizajni industrial është përfshirë në procedurën e falimentimit, me kërkesë të organit kompetent kjo e dhënë regjistrohet dhe publikohet në buletin e Zyrës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 27 Bankruptcy</p> <p>If the industrial design has been included in the bankruptcy procedure, by the request of the competent body, this fact is registered and published in the bulletin of the Office.</p>	<p style="text-align: center;">Član 27 Stečaj</p> <p>Ako je industrijski dizajn uključen u postupku stečaja, na zahtev nadležnog organa ovaj podatak se registruje i objavljuvanje u biltenu Kancelarije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 28 Aplikimi për regjistrimin e dizajnit industrial si objekt i pronës</p> <p>Dispozitat e neneve 23, 24, 25, 26 dhe 27 zbatohen edhe për aplikacionet për regjistrim të dizajneve industriale si objekte të pronës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Application for the registration of the industrial design as an object of property</p> <p>Provisions of articles 23, 24, 25, 26 and 27 shall be implemented for the applications of registration of the industrial designs as an object of property.</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Aplikacija za registraciju industrijskog dizajna kao objekat svojine</p> <p>Odredbe članova 23, 24, 25, 26 i 27 sprovode se isto za aplikacije za registraciju industrijskih dizajna.</p>
<p style="text-align: center;">KREU VII</p> <p style="text-align: center;">APLIKIMI PËR REGJISTRIMIN E DIZAJNIT INDUSTRIAL</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER VII</p> <p style="text-align: center;">APPLICATION FOR REGISTRATION OF AN INDUSTRIAL DESIGN</p>	<p style="text-align: center;">GLAVA VII</p> <p style="text-align: center;">APLIKACIJA ZA REGISTRACIJU INDUSTRIJSKOG DIZAJNA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Inicimi i procedurës për regjistrimin e dizajnit industrial</p> <p>Procedura për regjistrimin e dizajnit industrial fillon me paraqitjen e aplikacionit në Zyrë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Initiation of the industrial design registration procedure</p> <p>The procedure for the registration of an industrial design shall be initiated by filing the application at the Office.</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Postupak za registraciju industrijskog dizajna</p> <p>Procedura za registraciju industrijskog dizajna počinje sa podnošenjem aplikacije u Kancelariji.</p>



Neni 30 Përmbajtja e aplikacionit	Article 30 Content of the application	Član 30 Sadržaj aplikacije
<p>1. Aplikacioni për dizajnin industrial duhet të përmbajë:</p> <p>1.1. Kërkesën për regjistrimin e dizajnit industrial;</p> <p>1.2. Të dhënat për paraqitësin e aplikacionit;</p> <p>1.3. Dukjen e dizajnit e cila duhet të jetë e përshtatshme për reprodukim. Nëse lënda e aplikacionit është dizajn dy dimenzional, ndërsa aplikacioni përmban kërkesën për shtyrjen e publikimit në pajtim me nenin 47 të ligjit, atëherë paraqitja e dizajnit mund të bëhet me mostër.</p> <p>2. Aplikacioni i dizajnit industrial duhet të përmbaj edhe:</p> <p>2.1. Emërtimin e produktit në të cilin zbatohet dizajni;</p> <p>2.2. Të dhënat për përfaqësuesin e autorizuar, autorizimin nëse paraqitësi i aplikacionit e posedon;</p> <p>2.3. Nëse është paraqitur aplikacioni i përbashkët, të dhënat për përfaqësuesin e përbashkët.</p> <p>3. Aplikacioni i dizajnit industrial mund të përmbaj:</p>	<p>1. Application for the industrial design shall contain:</p> <p>1.1. a request for registration of the industrial design;</p> <p>1.2. Information identifying the applicant;</p> <p>1.3. A representation of the design suitable for reproduction. However, if the object of the application is a two-dimensional design and the application contains a request for deferment of publication in accordance with article 47, the representation of the design may be replaced by a specimen..</p> <p>2. The application shall further contain:</p> <p>2.1. Indication of the product in which the design is intended to be applied;</p> <p>2.2. Information identifying the duly authorised representative if the applicant has appointed one;</p> <p>2.3. If there was a joint application, the information for the joint representative.</p> <p>3. In addition, the application may contain:</p>	<p>1. Aplikacija industrijskog dizajna treba da sadrzi:</p> <p>1.1. Zahtev za registraciju industrijskog dizajna;</p> <p>1.2. Podatke za podnosioca aplikacije;</p> <p>1.3. Izgled dizajna koja treba da bude pogodna za reprodukciju. Ako predmet aplikacije je dvo dimenzionalni dizajn, dok aplikacija sadrži zahtev za pomeranje objavljvanje u skladu sa članom 47 ovog zakona, predstavljanje dizajna može da bude i sa uzorkom.</p> <p>2. Aplikacija industrijskog dizajna treba da sadrži i;</p> <p>2.1. Naziv proizvoda u kojem se sprovodi dizajn;</p> <p>2.2. Podatke za ovlašćenog predstavnika, ovlašćenje ako podnosilac aplikacije je poseduje;</p> <p>2.3. Ako je podnosena zajednicka aplikacija, podaci o zajedničkom predstavniku.</p> <p>3. Aplikacija industrijskog dizajna može da sadrži:</p>



<p>3.1. Përshkrimin me të cilin shpjegohet dukja apo mostra e dizajnit;</p> <p>3.2. Kërkesën për shtyrjen e publikimit të dizajnit të regjistruar në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;</p> <p>3.3. Klasifikimin e produktit respektivisht shënimin e klasës, në të cilin dizajni duhet të jetë pjesë përbërëse apo në të cilin dizajni duhet zbatuar, në pajtim me Marrëveshjen e Lokarnos, duke u bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar;</p> <p>3.4. Të dhënat për dizajnesin apo dizajnesit apo shënimet se dizajnesi apo dizajnesit nuk dëshirojnë të ceken;</p> <p>3.5. Të dhënat për dëshmitë për përparësinë sipas nenit 35 dhe 36 të këtij ligji.</p> <p>4. Forma dhe përmbajtja e aplikacionit për dizajn industrial dhe të gjitha pjesët tjera përbërëse të aplikacionit përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p>5. Të dhënat në aplikacionin për dizajn industrial të cekura në paragrafin 2 dhe paragrafin 3 nënparagrafi 3.1 dhe 3.3 të këtij neni, nuk ndikojnë në vëllimin e mbrojtjes së dizajnit.</p> <p>6. Aplikacioni përmban dëshmi për pagimin e tarifës së regjistrimit dhe të publikimit, ndërsa nëse është kërkuar shtyrja e publikimit sipas</p>	<p>3.1. A description explaining the representation or the specimen;</p> <p>3.2. a request for deferment of publication of the registration in accordance with Article 47 of this Law;</p> <p>3.3. Classification of the product, respectively inscription of the class, in which the product needs to be integral part or in which the design has to be implemented with the Locarno Agreement, based on the International Classification</p> <p>3.4. Information for the designer or the designers, or the statement that the designer or designers has waived the right to be cited;</p> <p>3.5. Information and evidence of the priority referred to in Articles 35 or 36 of this Law.</p> <p>4. The form and content of the application for industrial design and all the other constitutive parts of the application shall be defined by sub-legal act.</p> <p>5. Data on the application for the industrial design stated in the paragraph 2 and paragraph 3, paragraph 3.1 and 3.3 of this article; shall not affect the volume of protection of the design.</p> <p>6. The application shall evidence the payment of registration and publication fee, whereas if deferment has been required according to</p>	<p>3.1. Opis sa kojim se objasnjava izgled ili uzorak dizajna;</p> <p>3.2. Zahtev za pomeranje objavljivanja industrijskog dizajna koji je registrovan u skladu sa članom 47 ovoga zakona;</p> <p>3.3. Klasifikacija proizvoda odnosno obeležavanje klase u kojem dizajn treba da bude sastavni deo ili u kojem dizajn treba da se sprovede, u skladu sa Sporazumom Lokarna, a na osnovu Medjunarodne Klasifikacije;</p> <p>3.4. Podatke za dizajnera ili za dizajnere ili podatke dizajnera ili za dizajnere koji ne žele da ih isticu;</p> <p>3.5. Podatke za dokaze o prednostima iz clana 35 i 36 ovoga zakona.</p> <p>4. Aplikacija za industrijski dizajn i za sve ostale sastavne delove aplikacije odredjuju se za podzakonskim aktom.</p> <p>5. Podaci u aplikaciji za industrijski dizajn istaknutih u stavu 2 i stavu 3 podstavu 3.1 i 3.3 ovog člana, nemaju uticaja u obimu žastite dizajna.</p> <p>6. Aplikacija sadrži dokaz o uplati stope za registraciju i objavljivanja, i ako se tražili odlaganje objavljivanja prema stavu 3 podstav</p>
--	--	--



<p>paragrafit 3 nënparagrafi 3.2. të këtij neni, dëshminë për pagesën e tarifës për shtyrje.</p>	<p>paragraph 3 and 3.2 of this this article, shall contain the evidence of payment of deferment fee.</p>	<p>3.2. ovog člana, dokaz o uplati stope za odlaganje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 31 Aplikacioni i shumëfishtë i dizajnit industrial</p>	<p style="text-align: center;">Article 31 Industrial design multiple application</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Mnogobrojna aplikacija za industrijski dizajn</p>
<p>1. Nëse aplikacioni përmban disa dizajne, të gjitha produktet në të cilat dizajni është pjesë përbërëse, apo në të cilat dizajni do të zbatohet, klasifikohen në një klasë, në bazë të klasifikimit ndërkombëtar.</p>	<p>1. If the application contains several designs, all the products on which the design is constitutive part, or on which the design shall be incorporated, shall be classified in one class based of international classification.</p>	<p>1. Ako aplikacija sadrzi nekoliko dizajna, svi proizvodi u kojima je dizajn sastavni deo, ili u kojima se dizajn sprovodi, klasificiraju se u jednu klasu na osnovu medjunarodnog dizajna.</p>
<p>2. Në aplikacionin e shumëfishtë shënohet numri i dizajneve për të cilat kërkohet mbrojtja.</p>	<p>2. In the multiple applications, the number of the designs being requested for protection shall be noted.</p>	<p>2. U mnogobrojnu aplikaciju se navodi broj dizajna za koje se zahteva zastita.</p>
<p>3. Ndaj çdo dizajni që është përfshirë në aplikacionin e shumëfishtë, mund të veprohet ndaras, me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji. Dizajni në rastet e tilla mund të jetë lëndë e realizimit të të drejtave nga kontrata për licencë, hipotekës apo pengut, procedurës përmbarese, falimentimit, bartjes së të drejtave, shtyrjes së publikimit apo shpalljes së pavleshme të dizajnit.</p>	<p>3. For every design which is included in the multiple applications, may be acted separately with the purpose of implementation of provisions of this law. The design in such cases may be the subject of the rights from the license contract, mortgage or pledge, execution procedure, bankruptcy, transfer of the rights, publication deferment or invalidity of the design.</p>	<p>3. Prema svakom dizajnu koji je ukljucen u mnogobrojnu aplikaciju, moze da se deluje odvojeno, sa ciljem sprovođenja odredbi ovoga zakona. Dizajni u takvim slucajevima mogu da budu predmet realizacije prava iz ugovora za licence, hipoteke ili zaplene, postupku za izvršenje, stečaja, prenosu prava, pomeranju objavljvanje ili ne vazedećeg proglašavanja dizajna.</p>
<p>4. Aplikimi i shumëfishtë i nënshtrohet pagesës së tarifës shtesë të regjistrimit dhe publikimit.</p>	<p>4. The multiple applications shall be subject of additional payment fee for registration and publication.</p>	<p>4. Mnogobrojna aplikacija podleze placanju dodatnih stope za registraciju i objavljvanje.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 32 Ndarja e aplikacionit të shumëfishtë</p> <p>1. Paraqitësi i aplikacionit mund të ndajë aplikacionin e shumëfishtë në dy apo më tepër aplikacione, ashtu që çdo njëri mund të përmbajë një apo më tepër dizajne të produktit.</p> <p>2. Secili aplikacion i ndarë nga aplikacioni i shumëfishtë e fiton përparësinë e aplikacionit të shumëfishtë.</p> <p>3. Kushtet për ndarjen e aplikacionit të shumëfishtë përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Division of the multiple application</p> <p>1. The application may divide the multiple applications into two or more applications that each refers to one or more product designs.</p> <p>2. Each application separated from a multiple application shall retain the priority right of the latter application.</p> <p>3. The conditions for division of the multiple applications shall be defined by sub-legal act.</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Raspodela mnogobrojne aplikacije</p> <p>1. Podnosilac aplikacije može da deli mnogobrojnu aplikaciju na dva ili vise aplikacija tako sto svkai od njih moze da sadrzi jedan ili više dizajna proizvoda.</p> <p>2. Sfaki odvojena aplikacija od mnogobrojne aplikacije stice pravo prednosti mnogobrojne aplikacije.</p> <p>3. Uslovi za podelu mnogobrojne aplikacije odredjuje se sa podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 33 Data e aplikimit</p> <p>Data e aplikimit për dizajnin industrial është data kur Zyrës i janë paraqitur dokumentet që përmbajnë të dhënat e përcaktuara në nenin 30 paragrafi 1 të këtij ligji, nga ana e aplikuesit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 33 Application date</p> <p>The application date for the industrial design shall be the date when the documents, containing information as defined be article 30 paragraph 1 of this law, submitted by applicant at the Office.</p>	<p style="text-align: center;">Član 33 Datum aplikacije</p> <p>Datum aplikacije za industrijski dizajn je datum kada se predaju dokumenta Kancelariji a koja sadrže podatke odredjenih u clanu 30 stav 1 zakona, od strane podnosioca aplikacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 E drejta e përparësisë e fituar me aplikim</p> <p>1. Nëse aplikacioni për regjistrim të dizajnit industrial është paraqitur konform nenit 30 dhe 31 të këtij ligji, aplikuesi që nga data e</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 The priority right acquired by application</p> <p>1. If the application for registration of the industrial design has been submitted according to articles 30 and 31 of this law, the</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Pravo prednosti zarađena sa aplikacijom</p> <p>1. Ako aplikacija za registraciju industrijskog dizajna je predata u skladu sa članom 30 i 31 ovog zakona, podnosilac aplikacije od dana</p>



<p>paraqitjes të aplikacionit, ka të drejtën e përparësisë ndaj çdo aplikuesi tjetër, i cili paraqet më vonë aplikacion për regjistrim të dizajnit të njëjtë industrial.</p> <p>2. Aplikacioni i paraqitur sipas Marrëveshjes Ndërkombëtare nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës, fiton të drejtën e përparësisë sipas dispozitave të marrëveshjes.</p> <p>3. E drejta e përparësisë e kërkuar konform nenit 35 dhe 36 të këtij ligji, ka efekt ashtu që data e përparësisë llogaritet si data e paraqitjes së aplikacionit për dizajn industrial me qëllim të përcaktimit të të drejtave të cilat kanë përparësi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 E drejta e përparësisë</p> <p>1. Nëse aplikuesi për dizajn industrial ka paraqitur aplikacionin për herë të parë në ndonjë vend anëtar të Unionit të Parisit të themeluar me Konventën e Parisit për mbrojtjen e pronës industriale, me rastin e aplikimit për të njëjtin dizajn industrial në Republikën e Kosovës, mund të thirret në datën e aplikimit të parë, me kusht që</p>	<p>applicant from the date of submitting application has the right of priority towards any other applicant, who may submit later the application for registration of the same industrial design.</p> <p>2. Every application filed under an international agreement to which the Republic of Kosovo is a party shall also give rise to the priority of such an application according to the provisions of the agreement.</p> <p>3. The right of priority invoked according to Articles 35 and 36 of this Law shall have the effect that the date of priority shall be deemed as the date of filing of the industrial design application for the purposes of establishing which rights take precedence in accordance with paragraph 1 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 35 Priority right</p> <p>1. If an applicant has duly filed a first application for a design right in any State party to the Paris Convention, or to the Agreement Establishing the World Trade Organisation, in cases of application of the same industrial design in the Republic of Kosovo, may invoke the right of priority of the first application, under condition that he</p>	<p>predaje aplikacije, ima pravo na prednost prema svakom drugom podnosiocu aplikacije koji podnosi aplikaciju kasnije za registraciju istog industrijskog dizajna.</p> <p>2. Podnosena aplikacija prema Medjunarodnom Sporazumu ciji je potpisnik Republika Kosova, stiče pravo prednosti prema odredbama sporazuma.</p> <p>3. Pravo prednosti koja se zahteva prema članovima 35 i 36 ovoga zakona, ima uticaja tako sto datum prednosti smatra se datum podnosenja aplikacije za industrijski dizajn sa ciljem odredjivanja koja prava imaju prednosti u skladu sa stavom 1 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 35 Pravo prednosti</p> <p>1. Ako podnosilac aplikacije za industrijski dizajn je podnosio aplikaciju po prvi put u nekoj od zemalja članica Pariske Unije koja je osnovana Pariskom Konvencijom za zastitu industrijske svojine, prilikom aplikacije za isti industrijski dizajn u Republiku Kosova, moze se pozivati na dan aplikacije po prvi put, pod uslovom da aplikaciju na Kosovu učini u roku</p>
--	---	--



<p>aplikimin në Kosovë ta bëjë brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga kjo datë.</p> <p>2. Aplikuesi që thirret në të drejtën e përparësisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, Zyrës do ti paraqesë të dhënat themelore për aplikimin në të cilin thirret, shtetin, datën dhe numrin e aplikacionit, brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data e aplikimit në Zyrë, duke prezantuar përshkrimin e aplikacionit të parë të vërtetuar nga organi i autorizuar i shtetit anëtar të Unionit të Parisit si dhe përkthimin e përshkrimit.</p> <p>3. Nëse paraqitësi i aplikacionit nuk i përmbush kushtet konform paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohet se e drejta e përparësisë nuk është kërkuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 E drejta e përparësisë nga ekspozimi</p> <p>1. Nëse aplikuesi ka bërë ekspozimin e produktit që përbën dizajn industrial në ndonjë ekspozitë zyrtare ose në ndonjë ekspozitë ndërkombëtare zyrtarisht të pranuar në Kosovë ose në ndonjë shtet anëtar të Unionit të Parisit, mund të kërkojë që si datë e aplikimit të parë ti pranohet data e parë e ekspozimit të produktit, me kusht që paraqitjen e aplikacionit në Kosovë ta bëjë</p>	<p>files the application within a period of six (6) months from this date.</p> <p>2. The applicant invoking the right of priority from paragraph 1 of this Article shall indicate basic information pertaining to the application invoked as state, application date and number of application, within the period of three (3) months from the date of application at the Office, by presenting the description of the first application certified by the authorized body of the member state of the Paris Union, as well as the translation of the description.</p> <p>3. If the applicant does not fulfill the requirements stated in the paragraph 1 of this article, shall be considered that the right of priority has not been claimed.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Exhibition priority right</p> <p>1. If an applicant has disclosed products in which the design is incorporated, or to which it is applied, at an official or officially recognised international exhibition in the Republic of Kosovo or in the Member State of the Paris Union or the World Trade Organisation, he may, if he files the application within a period of six (6) months from the date of the exhibition.</p>	<p>od šest (6) meseci od ovog datuma.</p> <p>2. Podnosilac aplikacije koji se poziva na pravo prednosti u vezi sa stavom 1 ovog člana, u njegovom podnošenju u Kancelariji podnosice osnovne podatke za aplikaciju na kojoj se poziva, država, datum i broj aplikacije, u roku od tri (3) meseca od datuma podnošenja aplikacije u Kancelariji, tako sto predstavlja opis prve aplikacije overene od ovlašćenog organa države članice Pariske Unije kao i prevod opisa.</p> <p>3. Ako podnosilac aplikacije ne ispunjava navedene uslove iz stava 1 ovog člana, smatra se da pravo prednosti nije zahtevana.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Pravo prednosti izlozenja</p> <p>1. Ako podnosilac aplikacije je izlozio industrijski dizajn na nekoj sluzbenoj izlozbi ili na nekoj medjunarodnoj izlozbi koja je sluzbeno priznata na Kosovu ili u nekoj drzavi clanici Pariske Unije, moze da zahteva da kao datum podnošenja prve aplikacije da se prizna datum prve izlozbe proizvoda, pod uslovom da podnošenje aplikacije na Kosovu ucini u roku od šest (6) meseci od navedenog</p>
---	---	---



<p>brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga data e ekspozimit.</p> <p>2. Aplikuesi i cili thirret në të drejtën e përparësisë në bazë të datës së ekspozimit të produktit, është i detyruar që krahas aplikacionit, në Zyrë të paraqes edhe vërtetimin e lëshuar nga ana e organit kompetent të shtetit anëtar të Unionit të Parisit, në të cilin vërtetohen të dhënat për llojin e ekspozitës, vendin e mbajtjes së ekspozitës, datën e hapjes dhe mbylljes, ditën e parë të ekspozimit të produktit të emërtuar në aplikacion si dhe dëshmi për dizajnin e produktit të paraqitur në ekspozitë.</p> <p>3. Nëse paraqitësi i aplikacionit nuk i përmbush kushtet konform paragrafit 2 të këtij neni, konsiderohet se e drejta e përparësisë nuk është kërkuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Çertifikata e përparësisë</p> <p>Me kërkesë të aplikuesit ose pronarit të dizajnit industrial dhe pas pagesës së tarifës së caktuar, Zyra lëshon çertifikatën e përparësisë.</p>	<p>2. An applicant invoking the exhibition priority right from paragraph 1. of this Article shall, alongside the application filed to the Office, file a certificate issued by the competent authority of the Member State of the Paris Union, containing information concerning the type of the exhibition, venue, dates of opening and closing of the exhibition and the first day of exhibiting the products cited in the application, and evidence that the product design which was exhibited is identical to the one cited in the application..</p> <p>3. If the applicant does not meet the requirements set out in paragraph 2. of this Article, priority shall be deemed not to have been claimed..</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Certificate of priority</p> <p>At the request of the industrial design applicant or the industrial design holder and upon payment of the required fee, the Office shall issue a certificate of priority right.</p>	<p>datuma.</p> <p>2. Podnosilac aplikacije koji se poziva na pravo prednosti na osnovu izlozbe proizvoda obavezan je da da pored podnosenja u Kancelariji da podnosi i potvrdu izdatu od strane ovlasčenog organa drzave članice Pariske Unije u kojoj se potvrđuju podaci za vrstu izlozbe, mesto održavanja izlozbe, datum otvaranja i zatvaranja i prvi dan izlozbe proizvoda koji je naveden u aplikaciji, kao i dokaz za dizajn proizvoda koji je prđstavljen na izlozbi.</p> <p>3. Ako podnosilac aplikacije ne ispunjava navedene uslove u stavu 2 ovog clana smatra se da pravo prednosti nije zahtevano.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Certifikat prednosti</p> <p>Na zahtev podnosioca aplikacije ili vlasnika industrijskog dizajna i posle placanja zahtevane stope, Kancelarija izdaje certifikata prednosti.</p>
--	---	---



KREU VIII	CHAPTER VIII	GLAVA VIII
REGJISTRIMI I DIZAJNIT	REGISTRATION OF THE DESIGN	POSTUPAK REGISTRACIJE
Neni 38 Regjistri	Article 38 Register	Član 38 Registar
<p>1. Zyra mban regjistrin e aplikacioneve, në të cilin regjistrohen aplikacionet për regjistrim të dizajneve industriale të cilat i plotësojnë kushtet konform nenit 30 i këtij ligji dhe të cilave u është pranuar data e paraqitjes sipas nenit 33 të këtij ligji, si dhe regjistrin e dizajneve industriale, në të cilin regjistrohen dizajnet industriale për të cilat nuk është refuzuar regjistrimi sipas nenit 44 të këtij ligji.</p> <p>2. Përmbajtja e regjistrave përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p>3. Regjistri është publik.</p> <p>4. Nëse aplikacioni përmban kërkesën për shtyrje të afatit të publikimit të regjistrimit konform nenit 47 të këtij ligji, informata për këtë aplikacion ose regjistrim nuk është publike para publikimit të regjistrimit në pajtim me nenin 46 të këtij ligji.</p>	<p>1. The Office shall maintain a register in which applications for the registration of the industrial designs which comply with formal requirements from Article 30 of this Law and which have been accorded a filing date pursuant to article 33 of this Law will be entered, as well as industrial designs for which registration was not refused pursuant to Article 44 of this Law.</p> <p>2. The content of the register shall be regulated by this Law and by sub-legal act.</p> <p>3. The Register is public.</p> <p>4. If the application contains the request for deferment of publication of the registration in accordance with Article 47 of this Law, the information on this application registration shall not be public before the publication of the registration pursuant to the Article 46 of this Law.</p>	<p>1. Kancelarija ima registar aplikacija i registar industrijskih dizajna u kojima se registruju aplikacije za registraciju industrijskih dizajna koja su u skladu sa uslovima iz clana 30 ovog zakona i kojima je priznat datum podnosenja prema članu 33 ovog zakona, kao i industrijski dizajni za koje nije odbijena registracija prema članu 44 ovoga zakona.</p> <p>2. Sadržaj registra određuje se podzakonskim aktom.</p> <p>3. Registar je javan.</p> <p>4. Ako aplikacija sadrži zahtev za pomeranje roka objavljvanje registracije u skladu sa članom 47 ovog zakona, informacija za ovu aplikaciju ili registraciju nije javna pre objavljvanje registracije u skladu sa članom 46 ovog zakona.</p>



<p>5. Me kërkesë të palës së interesuar dhe pas pagesës së tarifës përkatëse, Zyra lëshon një ekstrakt nga regjistri.</p> <p style="text-align: center;">Neni 39 Buletini i Zyrës</p> <p>Zyra publikon buletinin e saj me të dhënat e përcaktuara me këtë ligji dhe akte nënligjore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Tarifat</p> <p>1. Për të gjitha procedurat e parapara me këtë ligj paguhen tarifa përkatëse.</p> <p>2. Llojet e tarifave dhe lartësia e tyre përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p>3. Nëse tarifat e parapara nuk janë paguar, aplikimi apo kërkesa refuzohet, kurse në rast të mos pagesës së tarifave për vazhdimin e mbrojtjes së dizajnit industrial, i njëjti pushon të vlejë.</p>	<p>5. At the request of the interested party, and after the payment of the required fee, the Office shall issue an extract and a printout from the register.</p> <p style="text-align: center;">Article 39 Office bulletin</p> <p>The Office shall publish the bulletin with the information defined by this law and sub-legal acts.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Fees</p> <p>1. For all the procedures regulated by this law, the respective fees shall be paid.</p> <p>2. Types and their amount of fees shall be defined by sub-legal act.</p> <p>3. If the fees have not been paid, the application or the request is rejected; while in the case of non-payment of the tariffs for continuation of the protection of the industrial design, the industrial design shall lapse.</p>	<p>5. Na zahtev zainteresovane stranke i posle plaćanja odgovarajuće stope Kancelarija izdaje jedan ekstrakt iz registra.</p> <p style="text-align: center;">Član 39 Bilten Kancelarije</p> <p>Kancelarija objavljuje svoju biltenu sa podacima odredjenim ovom zakonom i podzakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Takse</p> <p>1. Za predvidjene postupke sa ovim zakonom placaju se stope odredjene sa podzakonskim aktom.</p> <p>2. Vrste taksu i njihova visina se utvrđuju sa pozakonskim aktom.</p> <p>3. Ako predvidjene taksu nisu placane, aplikacija ili zahtev se odbija, dok u slucaju ne placanja takse za produzenje zastite industrijskog dizajna, isti prestaje da vredi.</p>
--	--	--



Neni 41 Kërkimi i risisë së dizajnit	Article 41 Search on novelty of the design	Član 41 Istraživanje novine dizajna
<p>Me kërkesë të palës së interesuar dhe pas pagesës së tarifës së caktuar, Zyra do të ofrojë shërbime që përfshijnë kërkimin e risisë së dizajneve të regjistruara që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.</p>	<p>At the request of an interested party and after the payment of the required fee, the Office shall provide the services comprising novelty search of the registered industrial designs, having effect in the Republic of Kosovo.</p>	<p>Na zahtev zainteresovane stranke i posle plaćanja određene stope, kancelarija će nuditi usluge koje uključuju zahtev za novine registrovanog dizajna koji su na snazi u Republiku Kosova.</p>
Neni 42 Përcaktimi i datës së paraqitjes së aplikacionit për dizajnin industrial	Article 42 Determination of the application date for industrial design	Član 42 Odredjivanje datuma podnosenja aplikacije za industrijski dizajn
<p>kërkesës ka filluar procedurën në gjykatë për të vërtetuar se ai nuk ka i shkelur në asnjë rast të drejtat e dizajnit industrial.</p> <p>3. Kërkesa e pranuar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk do të shqyrtohet derisa të mos jetë paguar tarifa përkatëse.</p> <p>4. Përmbajtja e kërkesës për anulim do të përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p>5. Arsyet për anulimin e dizajnit industrial të përcaktuara sipas nenit 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.5 të këtij ligji mund të kërkohen vetëm nga pronari i dizajnit.</p> <p>6. Arsyet për anulimin e dizajnit industrial të përcaktuar sipas nenit 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të këtij ligji, mund të kërkohen vetëm nga aplikuesi ose bartësi i së drejtës së përparësisë që është në kontest.</p> <p>7. Arsyet për anulimin e dizajnit industrial të përcaktuar sipas nenit 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të këtij ligji mund të kërkohen vetëm nga personi të drejtat e të cilit janë shkelur.</p> <p>8. Përveq rasteve të përcaktuara në paragrafët 5, 6, 7 të këtij neni, kërkesa për anulimin e</p>	<p>initiated the court procedure to prove that he has not, in any case, infringed the rights of industrial design.</p> <p>3. Application received according to paragraph 1 of this article, shall not be reviewed until the respective fee has been paid.</p> <p>4. Contents of the request for annulment shall be defined by sub-legal act.</p> <p>5. Reasons for annulment of the industrial design, defined by article 55 paragraphs 1 subparagraph 1.3 and 1.5 of this law may be requested only by the owner of the design.</p> <p>6. Causes for annulment of the industrial design, defined by article 55 paragraphs 1 and 1.4 of this law, may be invoked only by the applicant or the holder of the right of priority in the conflict.</p> <p>7. Causes for annulment of the industrial design, defined by article 55 paragraphs 1 and 1.6 of this law, may be invoked only by the person whose rights have been infringed.</p> <p>8. Except cases defined in the provisions set out in paragraphs 5, 6, 7 of this Article, the</p>	<p>odluke od suda da se dokaže da nije ugrozio prava za industrijski dizajn.</p> <p>3. Primitljivi zahtev prema stavu 1 ovog člana neće se razmatrati dok se ne uplati odgovarajuća stopa.</p> <p>4. Sadržaj zahteva za ponistenje određice se podzakonskim aktom.</p> <p>5 Razlozi za ponistenje industrijskog dizajna određenih prema članu 55 stav 1 podstav 1.3 i 1.5 ovog zakona mogu se zahtevati samo od vlasnika industrijskog dizajna.</p> <p>6. Razlozi za ponistenje industrijskog dizajna određenih prema članu 55 stav 1 podstav 1.4 ovog zakona, mogu se zahtevati ako podnosilac ili nosilac prava prednosti koji je u sporu.</p> <p>7. Razlozi za ponistenje industrijskog dizajna određenih prema članu 55 stav 1 podstav 1.6 ovog zakona mogu se zahtevati od lica čije je pravo ugroženo.</p> <p>8. Osim slučajeva određenih u stavovima 5, 6, 7 ovog zakona, zahtev za ponistenje</p>
--	---	---



<p>dizajnit industrial mund të parqitet edhe nga cilido person fizik ose juridik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 57 Shqyrtimi i kërkesës për anulimin e dizajnit</p> <p>1. Zyra shqyrton kërkesën për anulimin e dizajnit.</p> <p>2. Nëse Zyra konstaton se kërkesa është e pranueshme, atëherë Zyra vlerëson nëse arsyet për anulim, të përmendura në kërkesë, paragjykojnë vlefshmërinë e dizajnit industrial.</p> <p>3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Zyra i fton palët për të paraqitur të dhënat në lidhje me kërkesën, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të ftesës me shkrim.</p> <p>4. Me kërkesë të palës, afati kohor i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni mund të vazhdohet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë, pas pagesës së tarifës përkatëse.</p> <p>5. Në rastet kur Zyra vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për anulimin e dizajnit</p>	<p>request for the declaration of invalidity of an industrial design may be invoked by any natural or legal person.</p> <p style="text-align: center;">Article 57 Review of the design annulment request</p> <p>1. The Office reviews the application for annulment of the design.</p> <p>2. If the Office finds that the application for a declaration of invalidity is admissible, the Office shall examine whether the causes for invalidity referred to in the application prejudice the maintenance of the industrial design.</p> <p>3. In the examination of the application the Office shall invite the parties, to file information regarding the request within 60 sixty days from the day of receiving written invitation.</p> <p>4. Upon request of the applicant, the time limit referred to in paragraph 3 of this Article may be extended for a maximum sixty 60 days, after payment of the respective fee.</p> <p>5. In cases when the Office assesses that the requirements for annulment of the design are</p>	<p>industrijskog dizajna moze se prelati od bilo kog pravnog ili fizičkog lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 57 Razmatranje zahteva za ponistenje dizajna</p> <p>1. Kancelarija razmatranje zahteva za ponistenje dizajna.</p> <p>2. Ako Kancelarija utvrdi da je zahtev neprihvatljiv, onda Kancelarija proceno da razlozi za ponistenje , navedeni u zahtevu, predpostavljaju vrednost industrijskog dizajna.</p> <p>3. Tokom razmatranja zahteva, Kancelarija poziva stranke da predstave podatke u vezi sa zahtevom, u roku od šesdeset (60) dana od dana prijema pismenog poziva.</p> <p>4. Na zhtev stranek, vremenski rok naveden u stavu 3 ovog zakona moze da se produzi jos za šesdeset (60) dana, posle plaćanja odgovarajuće stope.</p> <p>5. U slučajevima kada Knancelarija proceni da nisu ispunjeni uslovi za poinistenje dizajna</p>
---	---	--



<p>sipas nenit 55 të këtij Ligji, atëherë Zyra me vendim e refuzon kërkesën për anulimin e dizajnit.</p>	<p>not met in accordance with article 55 of this law, then the Office through a decision, rejects the request for annulment of the design.</p>	<p>prema članu 55 ovog Zakona, tada Kancelarija uz odluku odbija zahtev za ponistenje dizajna .</p>
<p style="text-align: center;">Neni 58 Bashkimi i kërkesave për anulimin e dizajnit</p>	<p style="text-align: center;">Article 58 Participation in the proceedings of annulment of a design</p>	<p style="text-align: center;">Član 58 Objedinjenje zahteva za ponistenje dizajna</p>
<p>1. Në rast të parashtrimit të kërkesës për anulimin e dizajnit të regjistruar, të paraqitur gjatë periudhës së mbrojtjes dhe derisa Zyra nuk ka marrë ende vendim, personi i tretë i cili dëshmon se kundër tij është filluar procedurë gjyqësore për shkak të shkeljes së dizajnit të njëjtë si dhe parashtruesi i kërkesës për anulim, mund të bashkohen si palë në procedurën për anulimin e dizajnit, me kërkesë të parashtruar Zyrës.</p> <p>2. Bashkimi i palëve në procedurë sipas paragrafit 1 të këtij neni, zbatohet edhe në rastet kur pala e tretë dëshmon që pronari i të drejtës së dizajnit industrial ka kërkuar që ai të ndërpresë shkeljen e dyshuar të dizajnit dhe se pala e tretë ka filluar procedurën për të vërtetuar se ai nuk ka shkelur dizajnin.</p> <p>3. Kërkesa e përbashkët e palëve paraqitet me shkrim dhe përfshinë deklarinimin e arsyeve të</p>	<p>1. In the event of an application for a declaration of invalidity of a registered industrial design being filed during the protection period, and as long as no final decision has been taken by the Office, any third party who proves that proceedings for infringement of the same design have been instituted against him may be joined as a party in the invalidity proceedings on request submitted to the Office.</p> <p>2. Joining of the parties in the procedure in accordance with paragraph 1 of this article shall also apply in cases to any third party who proves that the right holder of the industrial design has requested that he cease an alleged infringement of the design and that he has instituted proceedings that he is not infringing the industrial design.</p> <p>3. Joint request of the parties shall be submitted in written and shall include causes</p>	<p>1. U slučaju predaje zahteva za ponistenje registrovanog dizajna, predstavljenog tokom perioda zastite i dok Knacelarija nije donela jos olluku, terca lica dokazuje da započela sudski postupak proton ugrozavanja dizajna kao i da podnosillac zahteva za ponistenje, mogu da objedine kao stranka u postupku za ponistenje dizajna, sa zahtevom predatim u Knacelariji.</p> <p>2. Objedinjenje stranaka u postupku prema stavu 1 ovog člana sprovodi se i u slucajevima kada terca strana dokazuje da vlasnik prava industrijskog dizajna zahtevala da prekine sumnjivo ugrozavanje dizajna i da je terca strana započela sa postupcima da se utvrdi da ona nije ugrozila dizajn.</p> <p>3. Zajednički zahtev stranka prijavljuje se pismeno i ukljucuje izjavu razloga za zahtev.</p>



<p>kerkesës. Kërkesa nuk do të shqyrtohet derisa të mos jetë paguar tarifa e përcaktuar në nenin 56 paragrafi 3 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 59 Efektet juridike të anulimit</p> <p>Nëse dizajni industrial anulohet apo shpallet i pavlefshëm, të gjitha efektet juridike që rrjedhin nga dizajni i regjistruar janë të pavlefshme.</p> <p style="text-align: center;">KREU XI REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR</p> <p style="text-align: center;">Neni 60 Regjistrimi ndërkombëtar i dizajnit industrial</p> <p>1. Regjistrimi ndërkombëtar i dizajnit bëhet në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Hagës.</p> <p>2. Aplikacioni për regjistrim ndërkombëtar të dizajnit industrial paraqitet drejtpërdrejtë në Zyrën Ndërkombëtare.</p> <p>3. Tarifat për regjistrim ndërkombëtar të dizajnit paguhen drejtpërdrejtë në Zyrën</p>	<p>of the request. The request shall not be reviewed until the specified fee in article 56 paragraph 3 of this law has been paid.</p> <p style="text-align: center;">Article 59 Legal effects of the annulment</p> <p>If the industrial design is annulled or is declared invalid, all the legal effects of the registration of the design are invalid.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER XI INTERNATIONAL REGISTRATION</p> <p style="text-align: center;">Article 60 International registration of the industrial design</p> <p>1. The international registration of industrial designs shall be carried out in accordance with the provisions of the Hague Agreement.</p> <p>2. The applications for international registration of industrial designs shall be filed directly to the International Bureau.</p> <p>3. All the fees payable for the international registration of industrial designs shall be paid</p>	<p>Zahtev se nece razmatrati dok se ne uplati stope odredjena u članu 56 stav 3 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 59 Pravne posledice ponistenja</p> <p>Ako industrijski dizajn se ukida ili se proglašuje nevažećim, sve pravne posledice koja proizlaze iz registrovanog dizajna su nevažeće.</p> <p style="text-align: center;">GLAVA XI MEDJUNARODNA REGISTRACIJA</p> <p style="text-align: center;">Član 60 Medjunarodna registracija industrijskog dizajna</p> <p>1. Medjunarodna registracija dizajna vrši se u skladu sa odredbama Haskog Sporazuma.</p> <p>2. Aplikacija za medjunarodnu registraciju industrijskog dizajna direktno se predaje u Medjunarodnu Kancelariju.</p> <p>3. Takse za medjunarodnu registraciju dizajna plaćaju se direktno u Medjunarodnu</p>
--	---	---



<p>Ndërkombëtare.</p> <p>4. Në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Hagës, dispozitat e këtij ligji zbatohen sipas parimeve të përgjithshme për kërkesat për vazhdim të regjistrimit ndërkombëtar në Republikën e Kosovës, me përjashtim të neneve 42 dhe 43 të këtij ligji.</p> <p>5. Kërkesa për vazhdim nga paragrafi 4 i këtij neni, zëvendësohet me kohëzgjatje të afatit kohor konform nenit 44 paragrafi 4 i këtij ligji në afat prej katër (4) muajsh.</p> <p style="text-align: center;">KREU XII</p> <p style="text-align: center;">DIZAJNI I KOMUNITAR</p> <p style="text-align: center;">Neni 61 Efektet e dizajnit komunitar</p> <p>Aplikacionet për dizajn komunitar dhe dizajnet komunitare të mbrojtura para datës së hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian kanë efekt juridik në Republikën e Kosovës.</p>	<p>directly to the International Bureau.</p> <p>4. In accordance with the provisions of the Hague Agreement, the provisions of this Law shall apply to the requests for extension of the effects of the international registration to the Republic of Kosovo, with the exclusion of Articles 42 and 43 of this Law.</p> <p>5. In respect to the requests for extensions from paragraph 4 of this Article, the term from Article 44 paragraph 4 of this law shall be replaced by the period of four (4) months.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER XII</p> <p style="text-align: center;">COMMUNITY DESIGN</p> <p style="text-align: center;">Article 61 Effects of community design</p> <p>The effects of applications for Community Design filed and Community design acquired before the date of accession of the Republic of Kosovo to the European Union shall extend to the Republic of Kosovo.</p>	<p>Kancelariju.</p> <p>4. U skladu sa odredbama Haskog Sporazuma, odredbe ovog zakona sprovode se prema opstim principima za zahteve za produzenje medjunarodne registracije u Republici Kosova, sa izuzetkom planova 42 i 43 ovog zakona.</p> <p>5. Zahtev za nastavak iz stava 4 ovog člana, zamenjuje se sa duzinom trajanja vremenskog roka prema clanu 44 stav 4 ovog zakona u roku od četiri (4) meseca.</p> <p style="text-align: center;">GLAVA XII</p> <p style="text-align: center;">KOMUNITARSKI DIZAJN</p> <p style="text-align: center;">Član 61 Posledice komunitarskog dizajna</p> <p>Aplikacije za komunitarski dizajn i komunitarski dizajni zasticeeni pre dana ulaska Republike Kosova u Evropsku Zajednicu imaju pravne posledice u Republiku Kosova.</p>
---	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 62 Dizajni komunitar si dizajn i mëhershëm</p> <p>Konform neneve 6, 7, 8 dhe 55 të këtij ligji, aplikimet për regjistrim të Dizajnit Komunitar dhe Dizajneve Komunitare të mbrojtura konsiderohen si dizajne të mëhershme në raport me aplikimet për dizajne kombëtare dhe dizajneve kombëtare të regjistruara pas hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.</p>	<p style="text-align: center;">Article 62 Community design as an earlier design</p> <p>Within the meaning of articles 6, 7, 8 and 55 of this Law, applications for the registration of Community Designs as well as Protected Community Designs shall be considered as earlier designs in relation to the national design applications filed, and national designs registered upon such applications after the accession of the Republic of Kosovo to the European Union.</p>	<p style="text-align: center;">Član 62 Komunitarski dizajn kao raniji dizajn</p> <p>U skladu sa članovima 6, 7, 8 i 55 ovog zakona, aplikacije za registraciju Komunitarskog Dizajna i Komunitarskih Dizajna koji su zasticeeni smatraju se raniji dizajni u odnosu sa aplikacijama za nacionalne dizajne i nacionalnih dizajna koji su registrovani pre ulaska Republike Kosova u Evropsku Zajednicu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 63 Kalimi i aplikacionit të dizajnit komunitar</p> <p>Aplikacioni për dizajn komunitar i paraqitet Zyrës, në pajtim me nenin 34 paragrafi 2 të Rregullores për dizajnin komunitar, pasi të paguhet tarifa përkatëse.</p>	<p style="text-align: center;">Article 63 Forwarding an application for a community design</p> <p>Application of community design shall be presented to the Office, in accordance with article 34, paragraph 2 of the regulation for community design, after relevant fees are paid.</p>	<p style="text-align: center;">Član 63 Prelazak aplikacije komunitarskog dizajna</p> <p>Aplikacija za komunitarski dizajn predaje se Kancelariji, u skladu sa članom 34 stav 2 Pravilnika za komunitarski dizajn ako se uplati odgovarajuća stope.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 64 Ndalimi i përdorimit të dizajnit komunitar</p> <p>Nëse përdorimi i dizajnit komunitar, efekti i të cilit është përcaktuar në nenin 61 të këtij ligji, është në kundërshtim me përdorimin e dizajnit kombëtar të regjistruar para hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin</p>	<p style="text-align: center;">Article 64 Prohibition of usage of community design</p> <p>If the use of a Community Design referred to in Article 61 of this Law conflicts with the use of a national design acquired before the accession of the Republic of Kosovo to the European Union, or of a national design</p>	<p style="text-align: center;">Član 64 Zabrana upotrebe komunitarskog dizajna</p> <p>Ako je upotreba komunitarskog dizajna, čija posledica je određena u članu 61 ovog zakona, je u suprotnosti sa upotrebom nacionalnog koji je registrovan pre ulaska Republike Kosova u Evropsku Zajednicu, ili</p>



<p>Evropian, ose me aplikimin për dizajn kombëtar të regjistruar para hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, pronari i dizajnit kombëtar mund të fillojë procedurën për ndalimin e përdorimit të dizajnit komunitar në Republikën e Kosovës dhe zgjerimin e së drejtës së dizajnit në territorin e Republikës së Kosovës. Pronari dëshmon që dizajni komunitar është në kundërshtim me dizajnin kombëtar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 65 Mbrojtja e dizajnit komunitar</p> <p>1. Në rast të shkeljes së të drejtave të dizajnit komunitar zbatohen dispozitat për mbrojtjen e dizajnit kombëtar.</p> <p>2. Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të dizajnit komunitar vendos Gjykata kompetente për dizajn kombëtar.</p>	<p>application filed before the accession of the Republic of Kosovo to the European Union, the holder of such national design may institute a legal action, claiming prohibition of the use of the Community Design in the Republic of Kosovo and extended to the territory of the Republic of Kosovo. The plaintiff has to prove that the Community Design conflicts with his/her national design.</p> <p style="text-align: center;">Article 65 Protection of Community design</p> <p>1. In case of community design infringement of rights provisions for protection of national design will be applied.</p> <p>2. For all cases of infringements of the rights for the community design the competent Court for national design shall decide.</p>	<p>sa aplikacijom za nacionalni dizajn, koji su registrovani pre ulaska Republike Kosova u Evropsku Zajednicu, vlasnik nacionalnog dizajna moze da zapocne postupak, za zabranu upotrebe komunitarskog dizajna u Republiku Kosova i prosirenje prava za dizajn na teritoriji Republike Kosova i prosirenje prava na teritoriji Republike Kosova. Vlasnik dokazuje da je komunitarski dizajn u suprotnosti se nacionalnim dizajnom.</p> <p style="text-align: center;">Član 65 Zastita komunitarskog dizajna</p> <p>1. U slucaju ugrozavanja prava komunitarskog dizajna sprovode se odredbe za zastitu nacionalnog dizajna.</p> <p>2. Za sve slucajeve ugrozavanja prava komunitarskog dizajna odlučuje nadležni Sud za nacionalni dizajn.</p>
--	---	--



KREU XIII	CHAPTER XIII	GLAVA XIII
<p data-bbox="180 367 678 467">MBROJTJA CIVILO-JURIDIKE E DIZAJNIT DHE ZBATIMI I SË DREJTËS</p> <p data-bbox="142 513 716 581">Neni 66 Gjykata kompetente për dizajn industrial</p> <p data-bbox="130 623 728 724">Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të dizajnit industrial vendos Gjykata Kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.</p> <p data-bbox="163 805 695 911">Neni 67 Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të dizajnit</p> <p data-bbox="130 953 728 1128">Padinë në rast të shkeljes së të drejtave të dizajnit sipas këtij ligji kanë të drejtë ta ushtrojnë pronari i dizajnit dhe pronari i licencës ekskluzive sipas kontratës apo bartësi i së drejtës së dizajnit.</p> <p data-bbox="138 1209 720 1312">Neni 68 Procedura për konstatimin dhe ndalimin e shkeljes së dizajnit</p> <p data-bbox="130 1390 728 1422">1. Pronari i dizajnit mund të inicoj procedurë</p>	<p data-bbox="764 367 1337 467">CIVIL-LEGAL DESIGN PROTECTION AND IMPLEMENTATION OF THE RIGHTS</p> <p data-bbox="789 513 1310 581">Article 66 Competent court for industrial design</p> <p data-bbox="751 623 1350 760">For all of the cases of infringements of industrial design rights, the competent court shall decide in accordance with legal provisions in force.</p> <p data-bbox="781 805 1318 911">Article 67 Persons who have the right to claim for design rights protection</p> <p data-bbox="751 953 1350 1166">In case of infringement of the design rights according to this law, to proceed the indictment have the right the holder of the design and exclusive person or holder of the license according to the contract or holder of the design right.</p> <p data-bbox="789 1209 1310 1349">Article 68 Claim for declaration of and claim for termination of the infringement of design</p> <p data-bbox="751 1390 1350 1422">1. The holder of an industrial design may</p>	<p data-bbox="1377 367 1967 431">CIVILNO-PРАВNA ZAŠTITA DIZAJNA I SPROVODJENJE PRAVA</p> <p data-bbox="1409 513 1934 581">Član 66 Nadlezni sudovi za industrisjki dizajn</p> <p data-bbox="1373 623 1971 724">Za sve slucajeve povrede prava industrijskog dizajna odlučuje na kompetentni sud prema zakonskim odredbama na snazi.</p> <p data-bbox="1415 805 1923 911">Član 67 Subjekti koji imaju pravo da zatraze zastitu prava dizajna</p> <p data-bbox="1373 953 1971 1089">Optužnicu u slučaju kršenja prava dizajna po ovom zakonu, imaju pravo da vrše vlasnik dizajna i vlasnik ekskluzivne licence prema ugovoru ili nosioc prava na dizajn.</p> <p data-bbox="1404 1209 1934 1317">Član 68 Postupak za utvrđivanje i sprečavanja povreda dizajna</p> <p data-bbox="1373 1390 1971 1422">1. Vlasnik dizajna moze da pokrene postupak</p>



<p>në gjykatë për vërtetimin e shkeljes së të drejtave të dizajnit të tij, kundër personit i cili ka shkelur të drejtën e dizajnit, duke kryer pa autorizim ndonjë prej veprimeve të përcaktuara sipas nenit 17 të këtij ligji.</p> <p>2. Pronari i dizajni industrial mund të inicoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili ka shkelur dizajnin duke kryer pa autorizim ndonjë prej veprimeve të përcaktuara sipas nenit 17 të këtij ligji, duke kërkuar ndalimin e shkeljeve të tilla ose të ngjashme në të ardhmën.</p> <p>3. Pronari i dizajni mund të inicoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili ka ndërmarrë veprime pa autorizim, që kanë shkelur apo përbëjnë tentim serioz për shkelje të dizajnit dhe kërkon ndalimin e veprimeve të tilla.</p> <p>4. Procedura sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të incohet kundër personit i cili gjatë aktivitetit afarist kryen shërbime që përdoren në veprimet që shkelin dizajnin ose nga i cili mund të pasojë shkelja e dizajnit.</p>	<p>institute a legal action against a person who has infringed an industrial design by performing without authorization any of the acts referred to in Article 17 of this Law.</p> <p>2. The holder of an industrial design may institute a legal action against a person who has infringed an industrial design by performing without authorization any of the acts referred to in Article 17 of this Law, claiming termination of the infringement and prohibition of such and similar future infringements.</p> <p>3. The holder of an industrial design may institute a legal action against a person who has by performing any of the acts without authorization, caused a serious threat that his industrial design might be infringed, claiming termination of the acts concerned and prohibition of the infringement of the industrial design.</p> <p>4. The legal action referred to in paragraphs 1, 2 and 3 of this Article may also be instituted against a person who in the course of his/her business activity renders services used in the acts infringing an industrial design or from which infringement of an industrial design may follow.</p>	<p>na sulu za utvrdjivanje povrede prava njegovog dizajna, protiv lica koji povredio pravo dizajna, tako sto vrsi bez ovlasčenja neko od dela odredjenih prema clanu 17 ovog zakona.</p> <p>2. Vlasnik industrijskog dizajna moze da pokrene sudski postupak protiv lica koje povredilo dizajn tako sto je vrsilo bez ovlasčenja neko od dela predvidjenih prema clanu 17 ovog zakona, tako sto zateva zabranu takvih ili slicnih povreda i u buduće.</p> <p>3. Vlasnik dizajna moze da pokrene sudski postupak protiv lica koja je preduzela delovanje bez ovlasčenja, koja su prekršili ili sastavljaju pokušaj-ozbilni opasnost za povredu dizajna i zateva zabranu takvih dela.</p> <p>4. Postupak prema stavu 1, 2 i 3 ovog člana moze da se pokrene protiv lica koja je tokom poslovne aktivnosti čini usluge koje se koriste na decima koja povredjuju dizajn ili iz koga moze da proistekne povreda dizajna.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 69 Kërkesa për konfiskim dhe shkatërrim të produkteve</p> <p>1. Pronari i dizajnit mund të incoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili ka shkelur dizajnin duke kryer pa autorizim ndonjë prej veprimeve sipas nenit 17 të këtij ligji, dhe të kërkoj që produktet që shkelin dizajnin të hiqen nga tregu, të konfiskohen ose të shkatërrohen me shpenzimet të atij personi.</p> <p>2. Gjykata urdhëron masën e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, me shpenzime të të paditurit përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të veçanta që të mos ndërmirret një veprim të tillë.</p> <p>3. Shqiptimi i masës nga Gjykata sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në proporcion me shkeljen.</p>	<p style="text-align: center;">Article 69 Claim for seizure and destruction of products</p> <p>1. The holder of an industrial design may institute a legal action against a person who has infringed an industrial design by performing without authorization any of the acts referred to in Article 17 of this Law, claiming that the articles infringing the industrial design be removed from the market, seized or destroyed at the expense of that person.</p> <p>2. The court shall order the measures referred to in paragraph 1 of this article at the expense of the defendant, unless there are special reasons for not deciding so.</p> <p>3. When ordering the measure referred to in paragraph 1 of this Article, the court shall make sure that they are proportionate to the nature and seriousness of the infringement.</p>	<p style="text-align: center;">Član 69 Zahtev za zaplenu ili unistenje proizvoda</p> <p>1. Vlasnik dizajna moze da pokrene postupak protiv lica koji je povredio dizajn tako sto je bez ovlascenja ucinilo neka dela prema clanu 17 ovog zakona, i da zahteva da proizvodi koji povredjuju dizajn da se povuku sa trzista, da se zaplene ili uniste sa troskovima tog lica.</p> <p>2. Sud izriče meru predvidjenu prema stavu 1. ovog clana, sa troskovima tuzenog sem u slučajevima kada postoje posebni razlozi da se ne preduzme jedno takvo delovanje.</p> <p>3. Izricanje mere od Suda prema stavu 1 ovog člana, treba da bude u srazmeri sa povredom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 70 Kërkesa për kompensim të dëmit</p> <p>1. Pronari i dizajnit mund të incoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili i ka shkaktuar dëm duke kryer pa autorizim veprimet sipas</p>	<p style="text-align: center;">Article 70 The claim for damage compensation</p> <p>1. The holder of an industrial design may take a legal action against a person who has caused him damages by performing without</p>	<p style="text-align: center;">Član 70 Zahtev za nadoknadu stete</p> <p>1. Vlasnik dizajna moze da pokrene sudski postupak protiv lica koje je nanelo stetu tako sto je ucinilo bez ovlascenja dela prema clanu</p>



<p>nenit 17 të këtij ligji, dhe të kërkoj kompensim për dëmin e shkaktuar.</p> <p>2. Pronari i dizajnit mund të incoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet sipas nenit 17 të këtij ligji, duke kërkuar kompensimin në shumën që ai/ajo ka kërkuar në kontratën për licencën, nëse ajo ekziston.</p> <p>3. Pronari i dizajnit mund të incoj procedurë gjyqësore kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprime sipas nenit 17 të këtij ligji, ka përfituar pa bazë ligjore duke shkel dizajnin e huaj, dhe të kërkoj kthimin apo kompensimin e përfitimeve pa bazë.</p> <p>4. Kërkesat sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.</p> <p style="text-align: center;">Neni 71 Kërkesa për publikimin e aktgjykimit</p> <p>1. Pronari i dizajnit mund të kërkojë që aktgjykimi i gjykatës me të cilin vërtetohet shkelja e plotë apo pjesë e së drejtës së dizajnit, të publikohet në mjetet e informimit</p>	<p>authorization any of the acts referred to in Article 17 of this law, claiming compensation of damages.</p> <p>2. The holder of an industrial design may institute a legal action against a person who has performed without authorization any of the acts referred to in Article 17 of this law, claiming payment of remuneration in the amount that he/she would have claimed in the license agreement, if concluded.</p> <p>3. The holder of an industrial design may take a legal action against a person who has infringed an industrial design by performing without authorization any of the acts referred to in Article 17 of this law, without having basis for it in any legal transaction, claiming the return or compensation.</p> <p>4. The claims referred to in paragraphs 1, 2 and 3 of this article shall not be mutually excluding.</p> <p style="text-align: center;">Article 71 Claim for publication of the judgment</p> <p>1. The holder of the design may claim that the court decision which confirms complete or partial infringement of the design rights, to be published in public media, at the expense of</p>	<p>17 ovog zakona, i da zahteva nadoknadu stete za pretrpljenu stetu.</p> <p>2. Vlasnik dizajna moze da pokrene sudski postupak protiv lica koje je vrsilo bez ovlasčenja dela prema članu 17 ovog zakona, tako sto zhateva placanje nadoknade u irnosu koji on/ona zahtevalo u ugovoru za licencu, ako ona postoji.</p> <p>3. Vlasnik dizajna moze da pokrene sudski postupak protiv lica koje je cinilo dela bez ovlasčenja član 17 ovog zakona, stekao je bez zakonske osnove tako sto je povredilo tusji dizajn, i da zahteva povratak ili nadoknadu dobitaka bez osnove.</p> <p>4. Zahtevi prema stavu 1, 2 i 3 ovog člana ne isključuju jedna drugu.</p> <p style="text-align: center;">Član 71 Zahtev za objavljivanje presude</p> <p>1. Vlasnik dizajna moze da zahteva da presua suda sa kojim se potvrđuje potpuna ili delimicna povreda prava dizajna, da se objavi u sredstvima javnog informisanja, sa</p>
--	---	---



<p>publik, me shpenzimet e të paditurit.</p> <p>2. Gjykata vendos brenda kufijve të kërkesës për publikimin e tërësishëm ose pjesërisht të aktgjykimit dhe mjetin e informimit se ku do të bëhet publikimi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 72 Kërkesa për informacione</p> <p>1. Pronari i dizajnit industrial, i cili ka filluar procedurën për mbrojtjen e dizajnit në rastet e shkeljes, mund të kërkojë informacionet për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve që shkelin dizajnin.</p> <p>2. Kërkesa sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet në formë të padisë ose për marrjen e masave të përkohshme kundër:</p> <p>2.1. Personit kundër të cilit është ngritur padi sipas paragrafit 1 të këtij neni;</p> <p>2.2. Personit i cili në kuadër të aktivitetit të tij afarist posedon produkte për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelur dizajnin;</p> <p>2.3. Personit i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij afarist ofron shërbime, për të cilat</p>	<p>the defendant.</p> <p>2. The court shall decide, within the limits of the claim, on the means of the public communication where the judgment shall be published, and whether it shall be published entirely or partially.</p> <p style="text-align: center;">Article 72 Claim for information</p> <p>1. The owner of industrial design, which has begun proceedings to protect the design in cases of violation, may claim the provision of information on the origin and distribution channels of the goods infringing his/her industrial design.</p> <p>2. The claim referred to in paragraph 1. of this Article may be submitted in the form of a legal action or a provisional measure against:</p> <p>2.1. A person who has been sued in the civil proceedings referred to in paragraph 1 of this Article;</p> <p>2.2. A person who is within her/his business activities in possession of the goods suspected of infringing an industrial design;</p> <p>2.3. A person who provides within her/his business activities services suspected of</p>	<p>troskovima optuženog.</p> <p>2. Sud odlucuje u okviru ograničenja zahteva za potpuno ili delimično objavljivanje presude i sredstvo informisanja gde će završiti objavljivanje.</p> <p style="text-align: center;">Član 72 Zahtev za informacije</p> <p>1. Vlasnik industrijskog dizajna, koji je pokrenuo postupak za zaštitu dizajna u slučajevima povrede, može da traži informacije za poreklo i mrežu raspodele proizvoda koji povređuju dizajn.</p> <p>2. Zahtev prema stavu 1 ovog člana može da preda u obliku tuzbe ili za preduzimanje privremnih mera protiv:</p> <p>2.1. Lica protiv koga je podignuta tuzba prema stavu 1 ovog člana;</p> <p>2.2. Lica koje je u okviru svoje poslovne aktivnosti ima proizvode za koje postoji sumnja da su povredile dizajn;</p> <p>2.3. Lica koje je tokom obavljanja svoje poslovne aktivnosti nudi usluge, za koje se</p>
---	---	--



<p>dyshohet se shkelin dizajnin;</p> <p>2.4. Personave të cilët gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre afarist ofrojnë shërbime apo përdorin shërbimet e ofruara në aktivitetet e dyshuara që shkelin dizajn;</p> <p>2.5. Personit për të cilin dëshmohet se është përfshirë në prodhimin ose shpërndarjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve të dyshuara se shkelin dizajnin.</p> <p>3. Kërkesa për informacione për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përfshijë në veçanti:</p> <p>3.1. Informatat për emrat dhe adresat e prodhuesëve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronarëve të tjerë të mëparshëm të produkteve dhe shërbimeve, shitësve me shumicë dhe pakicë;</p> <p>3.2. Informatat për sasinë e prodhuara, shpërndara, pranuar dhe porositura, si dhe çmimin për produktet dhe shërbimet;</p> <p>4. Nëse personi në fjalë refuzon të ofrojë informacione pa arsye bindëse, ai/ajo është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.</p>	<p>infringing an industrial design;</p> <p>2.4. Persons who provide within their business activities services used in the activities suspected of infringing an industrial design;</p> <p>2.5. A person who is indicated by any of the mentioned persons as being involved in the manufacture or distribution of the goods or the provision of the services suspected of infringing an industrial design.</p> <p>3. The claim for information on the origin and distribution channels of the goods and services referred to in paragraph 1. of this Article may include in particular:</p> <p>3.1. information on the names and addresses of the producers, distributors, suppliers and other previous holders of the goods and providers of the services, respectively, as well as the intended wholesalers and retailers;</p> <p>3.2. information on the quantities produced, delivered, received or ordered, as well as the price obtained for the goods or services concerned;</p> <p>4. If mentioned person refuses to provide information without convincing reason, he/she are responsible for caused damage pursuant to legal provisions in force.</p>	<p>sumnja da su povredile dizajn;</p> <p>2.4. Lica koja tokom njihove poslovne aktivnosti nude usluge ili koriste nudjene usluge u sumnivim aktivnostima koja povredjuju dizajn;</p> <p>2.5. Lica za koje se dokaze da je ukljuceno u proizvodnji ili raspodeli proizvoda ili nudjenje sumnjivih usluga koja povredjuju dizajn.</p> <p>3. Zahtev za informacije za poreklo i mrezu raspodele proizvoda i usluga prema stavu 1 ovog člana moze da ukljuci posebno:</p> <p>3.1. Informacije za imena i adrese proizvodjaca, distributera, snadbevača i ostalih ranijih vlasnika proizvoda i usluga, prodavaca na malo i veliko;</p> <p>3.2. Informacije za proizvodene količine, podeljene, primljene ili naručene, kao i o cenoma za proizvode i usluge.</p> <p>4. Ako navedeno lice odbija da pruži informacije bez ubedjivajućih razloga, on/ona je odgovorno za stvorenu stetu, u skladu sa zakonskim odredbama na snazi.</p>
---	--	---



